REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 01-016/01-67897
Pejë, datë: 14 shtator 2026

P R O C E S V E R B A L

Nga takimi i **VII**-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **14 shtator 2026**, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, drejtori i ÇPJ-së, z.Arianit Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit të Financave, z.Gazmend Turku, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, dhe përfaqësuesit e OSCE-së dhe ZIP-it

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroj të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë. Po ashtu sqaroj që pika 2. Procesverbali i takimit të KPF-së 21.07.2026, është hequr nga rendi i dites.

Unanimishtë nga të gjithë anëtaret prezent u miratua ky rend dite,

1. Aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 21.07.2026.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2027-2029.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2026.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për formimin e Komisionit për ankesa lidhur me procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSB-së për vitin 2026.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2026.
9. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve privat Florin (Muharrem) Krasniqi, Venera (Mahir) Kelmendi, Bos Peter (William Mattjas), Arjeta (Mahir) Mala dhe Ramiz (Avdyl) Nikq, me qëllim të zgjerimit të rrugës dhe sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë si Interes Publik sipas PZHK-së.
10. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit privat *Luigj (Ilhami) Karagjija* me qëllim të krijimit hapësirës për shërbim kulturor dhe rekreativ si Interes Publik sipas PZHK-së.
11. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme private në pronësi të Hysnije (Alil) Jusaj, Ali (Ramë) Basha dhe Reliumd Group, me qëllim të realizimit të Interesit Publik: "Zgjerimi i rrugës si dhe Sigurimi i kushteve të nevojshme për funksionimin e bazës ushtarake në Bellopojë", si Interes Publik sipas PZHK-së.
12. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarit Rexhë (Avdi) Muriqi, me qëllim të sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë, si Interes Publik sipas PZHK-së.
13. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit privat Shani (Sejfullah) Kasapi, me qëllim të realizimit të Interesit Publik: "Krijimi i

hapësirave publike buzë Lumbardhit", si Interes Publik sipas PZHK-së.

14. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve privat Skender (Tahir) Jusaj dhe Blerim (Gani) Pupovci, të cilat do të merren me qëllim të realizimit të Interesit Publik: "Shërbim kulturor dhe rekreativ-hapësirë e hapur publike", si Interes Publik sipas PZHK-së.
15. Shqyrtimi dhe rekomandimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për periudhën kohore, 21 Korrik 2026.
16. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për shpalljen e konkursit për Komitetet Konsultative:

    1. Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, 2. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit dhe 3. Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
17. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e panelit përzgjedhës për Komitetet Konsultative.
18. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.
19. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.

2.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
Nuk ka pasur.

3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2027-2029.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: sa i perket buxhetit ju i dini procedurat që kanë rrjedhë. Deri më tani, janë mbajt diskutimet publike nga komisioni, kryetari dhe drejtoria për buxhet dhe financa dhe kemi ardh deri te drafti final. Po ashtu draftin final e qesim në shqyrtim edhe ne KPF pastaj edhe në kuvend në seancën e rregulltë që e mbajmë në fund të shtatori. Në material e keni mar draftin dhe e keni mujt me pas si analizë.

Znj. Valbona Taraku Gjakova: unë e kam një pyetje mbasi janë mbajtur dëgjimet buxhetore dhe ka pas kërkesa prej qytetarëve, sa janë përfshirë kërkesat e tyre në buxhetin e komunes?

Z.Labinot Panxha: qysh e kemi diskutu me koleg refuzojmë me marr pjesë në votim, ku prezent nuk janë drejtorët e digastereve të caktuar, në ketë rast drejtoresha e financave. Unë i kam dërgu e-mail edhe kryetarit edhe drejtoreshes, pasi që e analizova ketë draft final dhe e pash që nuk

janë përfshi kërkesat tona. Nese drejtoresha do të ishte prezent këtu sot, ish dasht me ma arsytu se përse nuk janë përfshi kërkesat tona sepse kanë qenë shumë të domosdoshme për ato lokalitete. Por përderisa drejtoresha nuk është prezent nuk e keni mundësinë me u përgjigjë ju, dhe as na nuk e kemi mundësinë me marr pjesë në votim.

Z.Ardit Gërvalla: fillimishtë deshta me diskutu sepse ne email e kemi pranu draft planifikimi i buxhetin 2027-2029, por na është thënë aty se ky dokument është ende në fazen e draftit dhe nuk është ende në versionin finale, ndërsa versionin përfundimtar ju dërgojmë ndërkohë. Por ne si anëtar nuk e kemi pranu ende draftin përfundimtar, se nese e votojmë sot ketë draftë kjo nënkupton që nuk e kemi aprovu draftin final. Kishte me qenë mirë me na tregu se a ka ndodhë ndonjë ndryshim gjatë kesaj kohe prej qe e kemi pranu e-mailin? Ndërsa sa i perket draft planifikimit të buxhetit e kam analizu ketë pjesë, dhe sa i përket kërkesave mirë e ka Labi që tha për kërkesa, në diskutime publike është kërku që kërkesat me i sjellë në kopje fizike. Unë i kam dërgu dhe e pash që janë të përfshira disa, por edhe kërkesat e qytetarëve që janë adresu në këto diskutime publike, thuhet që janë aprovu pjesërishtë. Ndërsa nuk saktësohen se cila pjesë e kërkeses është aprovu dhe cila jo. Kishte me qenë mirë për shkak të transparencës dhe korektësisë të gjitha kërkesat që janë adresu me u dit se cila pjesë është aprovu dhe cilat nuk janë aprovu, apo në cilin vitë është parapa me hy kërkesa e tyre në planifikimet buxhetore. Sa i perket subvensionimeve më ka bo përshtypje një mungesë e planifikimit sa i perket ndarjeve të bursave! Duke pas parasysh se për 3 vitet e ardhshme është parapa 30.000 euro buxhet për student. Duke pa qe kemi deficit të profesioneve në komunen e Pejës e sidomos në matematikë, fizikë, kimi, biologji kishte me qenë mirë me u nda një pjesë e subvensioneve për keta student, duke i inkuraju këta student në këto drejtime dhe pse jo komuna me pagu komplet koston e këtyre studimeve. Po mendoj që shuma prej 30.000 euro është e pamjaftushme dhe problemin kryesor dhe shtylla kryesore është çështja e arsimit. Ne nuk mundemi me kalu ketë çështje pa pas një plan të mirëfilltë, dhe unë nuk po shoh një strategji se qysh me ju qas arsimit seriozishtë. Tek çështja e investimeve kapitale unë e kam një pyetje të cilen do ta adresoj edhe për seancë, e kam pa që ndërtimi i kanalizimit në fsh. Kryshec nuk është parapa për vitet 2027-2029 si buxhet. Kishte me qenë mirë me na sqaru se pse nuk është hy në buxhet? Të planifikohet ndërtimi i kanalizimit në fsh.Kryshec, kjo ka qenë edhe kërkesë e imja në dëgjimet buxhetore që janë mbajt në fsh.Baran. Po ashtu e mirëpres hyrjen në ketë planifikim çështjen e pastrimit të lumit në Behoc. Hapja e kanalit të Behocit është parapa në vitin 2028 90 mijë euro dhe 2029 janë parapa 200 mijë euro. Pse nuk është parapa në vitin 2027 mbasi është veq hapja e kanalit, fakti që nuk ka ndërtim, le të jetë një kërkesë e imja sepse është jashatëzakonishtë i nevojshem të bëhet hapja e kanalit sepse po bën dëme. Unë i kam edhe disa çështje të tjera po përderisa nuk është prezent drejtoresha po është problem, pasi që ne këtu nuk jemi prezent vetem në mënyrë formale por të përgatisim edhe kuvendin të jetë me kualitativ. Përderisa nuk janë disa drejtora prezent ne po e kemi të pa mundur me debatu e me diskutu, por po flasim vetem sa për procesverbal.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: draf buxheti mund të pësoj ndryshme deri në momentin sa të dërgojmë në kuvend. Sepse me daten 16 kemi edhe një takim diskutim publik edhe aty meren

kërkesat të arsyshme atëhere mund te ketë ndryshim . Ndërsa drafti përfundimtar i buxhetit ende nuk ka ardh te ju, mund te ketë disa ndryshme të vogla në mallra dhe sherbime dhe në subvecione.

Z.Gazmend Turku: kryesishtë drafti që është punu është punu në bazë qarkores së dytë buxhetore. Vijat buxhetore thuaja janë të njejta me ato që i keni pa, kanë ndryshu vetem paga dhe meditjet dhe shpenzimet kapitale. Janë ulë shpenzimet dhe janë rrit paga dhe meditjet, pjesa tjeter e tri kategorive ka mbet e njejtë. Tash e shohim edhe te merkuren në diskutim publik por kryesisht drafti ka me qenë i njejt. Kërkesat e juaja janë mar e keni pa edhe në raport, për secilen kërkesë ka përgjigje dhe janë në shqyrtim.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 4 votë pro, 5 anëtar nuk marin pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ne si kuvend e kemi mar vendimin që këto komitete me i pagu. Komitetet kosultative i mbajnë 6 takime brenda vitit. Deri me tani kanë qenë pagesa 50 euro për një takim, tani jemi duke e shqyrtu që me rrit vleren e pageses. Mirëpo deri në senacën e rregulltë duhet të marim vendim a duhet të rrisim vleren e pageses.

Z.Labinot Panxha: deshta me bo një pytje lidhur me keto pagesa. Unë, Avnia, Edonjeta, Arditi i kemi mbajt thuja gjitha takimet si komision për stautin e komunës së Pejë. Mirëpo asnje pagese nuk e kemi mar deri tash! Pavarsisht nese vjen apo jo statuti në kuvend për miratim apo refuzim, ne i kemi mbajt ato takime dhe duhet me u kompenzu.

Z.Ardit Gërvalla: sa i perket komiteteve konsultative e kam pa që janë të parapame me rregullore të kuvendit. Kishte me qenë mirë me ardh një raport i këtyre komitetve në të kaluaren se çka kanë bo me arsyetu njëfar mënyren edhe punen e tyre, dhe produktibitetin që këto komitete e bëjnë për komunen e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: po gjitha raportet e komisioneve në fund të vitit i prezenohen kuvendit, disa edhe dalin në fund të vitin edhe i prezentojnë në kuvend.

Nga të gjithë anëtaret prezent 5 votë pro, 2 votë të përmbajtur, 2 anëtar nuk marin pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: këshillat lokal e kanë mandatin 4 vjeqar, po ashtu i mbajnë 6 takime në vjet dhe janë të obliguar që në fund të vitit të dorzojnë raportet dhe procesverbalet e

takimeve të mbajtura. Po ashtu në senacë e marim vendim edhe për kompenzimin e tyre. Ky komision përbëhet nga 7 anëtar, një anëtar nga kuvendi, një nga ekzekutivi, një anëtar nga shoqeria civile.

Unanimishtë nga gjithë anëtaret, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për formimin e Komisionit për ankesa lidhur me procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: formohet edhe komision i ankesave dhe përbëhet nga 3 anëtar. Ky komision i mer ankesat nese ka gjatë procedurave.

Unanimishtë nga gjithë anëtaret , i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSB-së për vitin 2026.

Kryesusis Rexhep Kurtbogaj: po ashtu edhe për ketë komitet duhet të meret vendimi për kompensimin e takimeve që i mbajnë.

Z.Bekim Morina: unë mendoj që duhet të shikohet kjo çështje sepse të gjitha këto komitete nuk e kanë funksionin e njejtë dhe nuk duhet të kompensohen njejtë.

Nga të gjithë anëtaret prezent 7 votë pro, 2 votë të përmbajtur, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

8.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2026.

Kryesusi Rexhep Kurbogaj: edhe kjo pikë është për kompensimin e kryesuesve të këshillave lokale.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro, 2 votë të përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

9.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve privat Florin (Muharrem) Krasniqi, Venera (Mahir) Kelmendi, Bos Peter (William Mattjas), Arjeta (Mahir) Mala dhe Ramiz (Avdyl) Nikq, me qëllim të zgjerimit të rrugës dhe sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë si Interes Publik sipas PZHK-së.

Z.Arianit Krasniqi: bëhet fjalë për këmbimin e pronave private me prona publike me qëllimi të realizimit të disa intersave publike zgjërmit të rruges dhe sigurisë të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake (prezentimi në foto). Në material i keni sipërfaqet i keni dhe çmimet e vlersimeve.

Z.Labinot Panxha: rruga aktuale tek "Universi" është e ndertume dhe është në pronësi të fabrikes që është e jepne për 99 vjet. Tash kjo rrugë që po jepet për me mar ketë rrugë të komunes te restorant Blini po i jepet Florinit, për me mar rrugen që është e jepne për, 99 vjet dhe është në pronësi prap të Florinit të dyjat.

Z.Arianit Krasniqi: në momentin që agjensioni kadastral e ka pranu bashkimin e pronave me qirra mbajtje edhe pronat privat, atëhere nënkupton që ky i ka të drejtat e pa kontestushme.

Z.Ardit Gërvalla: po e kuptoj interesin publik zgjerimin e rruges, por cili është interesi publik sepse këtu po e lexoj sigurimin e kushteve të bazave ushtarake, çka po e pengon interesin publik spo kuptoj?

Z.Arianit Krasniqi: aty ka nevoj me pas KFORI zonen e sigurisë.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro, 4 kundër, rekomandohet për shqyrtim në kuvend.s

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit privat *Luigj (Ilhami) Karagjija* me qëllim të krijimit hapësirës për shërbim kulturor dhe rekreativ si Interes Publik sipas PZHK-së.

Z.Arianit Krasniqi: edhe këtu bëhet fjalë për një këmbim të realizimit të interesit publik me qëllim të krijimit të hapsirës për shërbim kulturor dhe rekreativ (prezentimi në foto).

Pas disktutimeve e qesim në votim me 5 votë pro, 2 votë kundër, 2 anëtar nuk marin pjesë në votim, i rekomandohet për shqyrtim në kuvend.

11.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme private në pronësi të Hysnije (Alil) Jusaj, Ali (Ramë) Basha dhe Reliumd Group, me qëllim të realizimit të Interesit Publik: "Zgjerimi i rrugës si dhe Sigurimi i kushteve të nevojshme për funksionimin e bazës ushtarake në Bellopojë", si Interes Publik sipas PZHK-së.

Z.Arianit Krasniqi: e kemi prap qëllimin e interesit publik me qëllim të realizimit zgjërimi i rruges dhe sigurimi i kushteve të nevojshme për funksionimin e bazes ushtarake në Bellopojë sipas planit të PZHK-së sipërfaqet dhe vlersimet i keni në material (prezentimi në foto).

Pas disktutimeve e qesim në votim me 5 votë pro, 4 votë kundër, i rekomandohet për shqyrtim në kuvend.

12.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarit Rexhë (Avdi) Muriqi, me qëllim të sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë, si Interes Publik sipas PZHK-së.

Z.Arianit Krasniqi: edhe kjo pronë këmbehet për qëllim të interesit publik me qëllim të sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë, si interes publik sipas planit zhvillimor komunal (prezentimi në foto).

Z.Naim Bytyqi: a mundem me i hulumtu na blerjet tek KFORI kur janë bo prej qytetarëve? Sepse nese janë bo pas vitit 2023 blerjet qaty unë mendoj që është e jashtëligjshme me u këmby.

Z.Arianit Krasniqi: KFORI i bën kërkesat , dhe unë thash është dasht me shku edhe pa drejtë me mar vendim me j'a rrënu njerit shpin e vet për shkak se është ardh gjenerali dhe neve na është dasht me rrethu.

Z.Naim Bytyqi: a ka rast që e ka ble dhe e ka dit që nuk lejohet ndërtimi?

Z.Arianit Krasniqi: nuk besoj që ka raste.

Z.Labinot Panxha: Arianit ai ka drejt me ble ku të ka qejf, po pse na komuna duhet me j'a bo zgjidhjen, qetu o dilema?

Z.Ardit Gërvalla: kjo rruga te Toskana a përdoret prej qytetarëve qajo lagje?

Z.Arianit Krasniqi: jo nuk përdoret prej qytetarëve, nese doni ne mundemi me dal ne teren në vend të ngjarjes kur të doni dhe me pa!

Nga të gjithë anëtaret prezent 5 votë pro, 4 kundër, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

13.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit privat Shani (Sejfullah) Kasapi, me qëllim të realizimit të Interesit Publik: "Krijimi i hapësirave publike buzë Lumbardhit", si Interes Publik sipas PZHK-së.

Z.Arianit Krasniqi: edhe këtu bëhet fjalë për këmbimin e pronës së komunës me pronen private me qellim të realizmit interesit publik krijimin e hapsirave publike buzë Lumbardhit sipas planit zhvillimor komunal (prezentimi në foto). Në senacën e kuvendit ju vjen materiali komplet me krejt vlersimet.

Znj. Valbona Taraku Gjakova: qysh mendoni me bo këmbimin e prones private me pronarin i cili ka vdek? Sepse nuk mundesh me bo kontratë me një përson të vdekur. Por duhet me qenë me trashigimtarë dhe sa kanë drejt ata, sepse me njerzë të vdekur nuk është e realizueshme dhe e ligjshme.

Z.Labinot Panxha: për gjatë shetitores janë të këmbyme pronat, ne e dim se sa m2 janë këmby për secilen pronë. Pse për shembull gjatë shetitores egzistojnë ende ato objekte të cilat shfrytëzohen nga ata pronar, dhe nuk ka ndërmar komuna asgjë në lidhje me largimin e tyre?

Z.Arianit Krasniqi: kur është fillu procedura me bo shpronësimin i ndjeri ka qen gjallë, ai ka pas aksident dhe ka ndërru jete. Por i ka trashigimtarët dhe ata e kanë përfundu trashigimin, por vlersimet na kanë ardh me emrin e të ndjerit dhe ne kemi vazhdu. Trashigimtarët janë deklaru se janë të gatshem me vazhdu me procedura tjera. Sa i perket pyetjes së Labit, për fat të keq kontrata për rrënimin e objekteve na ka shku në OSHP, dhe jemi të prolongum të kësaj pune sepse janë do shtëpi që na duhet me i rrënu. Sa po të bëhet kontrata meret vendimi për rrënimin.s

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk marin pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

14.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve privat Skender (Tahir) Jusaj dhe Blerim (Gani) Pupovci, të cilat do të merren me qëllim të realizimit të Interesit Publik: "Shërbim kulturor dhe rekreativ-hapësirë e hapur publike", si Interes Publik sipas PZHK-së.

Z.Arianit Krasniqi: kjo pronë është te pjesa e ures që është ndërtu tek Universi, më heret është këmby pjesa tjeter tash vazhdojmë me pjesen tjeter, me qëllim të realizimit të interesit publik (prezentimi në foto).

Z.Labinot Panxha: a mundesh me na tregu neve sa ari po i këmben komuna të vetat me përsona fizik? Sa ari po i jep dhe sa po i merr?

Z.Arianit Krasniqi: 38 ari i jep komuna dhe i mer 2 ari e 80 metra, po këtu hyn në vlersime edhe objektet e ndërtuara normalishtë edhe ato e kanë koston e vet.

Z.Labinot Panxha: këtu po këmbehen prona, objektet nuk llogariten

Z.Arianit Krasniqi: jo këtu nuk mundesh me thonë toka është interes publik e objektin nuk ta llogaritim , është obligative me j'a pagu.

Z.Ardit Gërvalla: është e vërtet që kam qenë pjesë tatimit në pronë dhe vlersimi ka qenë në departament tjeter. Komuna i drejtohet departamentit për vlersimin e pronave të paluajtshme me kërkesë individuale për pronen, pastaj këmbimin edhe vleren vendos komuna. Pra argumentimi që ministria e ka bo vlersimin nuk mundet mu marr për arsytim, sepse organi i kuvendit komunal është ai që vendos. Po më duhet vetem me dit se sa e ka përcaktu ministria vleren për 2 ari e 80 metra?

Z.Arianit Krasniqi: i keni krejt në material, prona komunale totali si hapsirë 38 ari është 305 mijë 640 euro, ndërsa prona private e Skender Jusaj është 106 mijë e 400 euro që i bjen 450 euro

është vlersu ari dhe vlera e investimeve është 70 mijë euro. Ndërsa edhe prona tjeter bashkarishtë me pronar Blerim Popovci është vlersu 209 mijë e 208 euro, gjithësej bashkë janë vlersuar 315 mijë e 650 euro.

Nga të gjithë anëtaret prezent 5 votë, 3 kundër, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

15.Shqyrtimi dhe rekomandimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për periudhën kohore, 21 Korrik 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: raportin e keni nese keni diqka e hapim diskutimin, nese jo pastaj në kuvend zyrtarët janë prezent.

Z.Labinot Panxha: unë e kam pa listen dhe në parim për mua është në rregullë, por duhet me pas sqarime prej atyre që i kanë bo vlersimet. Sepse aty ka shuma prej 55 mijë euro dhe ne nuk e dim se çka është dëmtu në ketë shumë, dhe sa është sipërfaqja që ka qenë e parapame që të meret ai rendiment nese është fjala për dëme bujqësore. Si listë është në rregullë por raportin nuk e kam pa nuk është hap e-maili, por jam pro për me u kompenzu ata njerzë.

Nga të gjithë anëtaret prezent 6 vote pro, 2 anëtar nuk marin pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

16.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për shpalljen e konkursit për Komitetet Konsultative:

- ***1. Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, 2. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit dhe 3. Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.***

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: këto komitete janë trupa ndihmes të kuvendit dhe tash ju kalon afati dhe duhet të bëhet shpallja e konkursit për riorganizim të këtyre komiteteve.

Unanimishtë nga të gjithë anëtaret prezent, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

17.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e panelit përzgjedhës për Komitetet Konsultative.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe kjo është procedurë ky panel përzgjedhës përbëhet nga 5 anëtar dhe e bëjnë përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve.

Unanimishtë nga të gjithë anëtaret prezent, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

18.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: një raport e keni mar nga drejtoria e arsimit, drejtori nuk është prezent por në senacën e kuvendit do të jet i pranishem për sqarime tjera.

Z.Ardit Gërvalla: te çështja e fillimit të vitit shkollor ne e kemi pa një raport një faqe e gjysë dhe faqja e parë ma shumë logo të komunes. Nuk është në rregullë mos me ardh drejtori i arsimit në fillim vit me raportu për KPF-në. Kritikë shumë e madhe dhe besoj që pajtohen krejt anëtaret. Për mua si anëtar kjo tregon nivelin e përkushtimit të drejtorit për arsimin në komunen e Pejës.

Nga të gjithë anëtaret prezent 5 votë pro, 3 anëtar kundër, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

19.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.
Nuk ka pasur.

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:15 h.

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina

K R Y E S U E S I,
z. Rexhep Kurtbogaj

